VENDIM
Nr. 215, datë 9.4.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 878, DATË 24.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 14, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 878, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në vendim, emërtimi "ministri i Shtetit për Rindërtimin" zëvendësohet me fjalët "ministri përgjegjës për rindërtimin".

2. Shkronjat "c" dhe "dh", të pikës 1, të kreut II, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"c) ministrin e Financave;"

...

"dh) ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku